

http://shekulli.com.al/web/p.php?id=10014&amp;kat=94

Go

MAR APR MAY

14

2012 2013 2014



About this capture

29 captures

2 Dec 2012 - 15 May 2013



Kalo në Abissnet  
pa ndryshuar numrin  
e telefonisë fikse

▲ 2000 lekë  
kohë bisedë dhuratë

▲ Çmimet deri  
-70% më lirë

▲ 0 lek  
tarifë fikse mujore

+ 1 muaj internet falas  
nëse lidh edhe internetin.



▲ tërheqja e  
parezistueshme  
e lirisë

www.abissnet.al

E Dielë, 14.04.2013

Marketing



Arkiva e tajeve

K?rkoni ...

SHEKULLI  
PRINT

RADAR

JETË

THELLË

TRUP &amp; SHPIRT

KULTURË

## Kulturë

► [Kreu](#) | [Lajmi i fundit](#) | [Politikë](#) | [Kronikë](#) | [Ekonomi](#) | [Opinion](#) | [Kosova](#) | [Rajon](#) | [Botë](#) | [Sport](#) | [Teknologji](#) | [Soft](#) | [Letra](#)

## Vihet në vend dinjiteti i Ivanajve

- Shtëpia që ka shërbyer si administratë për Sigurimin e Shtetit dhe për Gardën e Republikës, i kthehet trashëgimtares së vetme të vëllezërve Ivanaj: Martinit, avokat i shquar i viteve □30 dhe Mirashit, reformatori i arsimit në epokën e Zogut

Publikuar më 02.12.2012 | 16:01



Jeta e Drita Ivanajt ka qenë gjithmonë ajo e një udhëtari të ngarkuar me baulen e kohës. Në fillim e përzunë nga streha e saj, më tej përjetoi ndarjen për së gjalli të familjes, ikjen nga kjo botë të babait pa pasur mundësi ta lehtëtojë për herë të fundit, mërgimin në Itali e më tej në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Historia e Drita Ivanajt, është ajo e vetë familjes Ivanaj, babait të saj Martinit dhe xhaxhait, Mirashit, i shquar për reformat në arsim në një periudhë ku analfabetizmi ishte shtruar këmbëkryq. Tanimë në moshën 78-vjeçare, Drita Ivanaj, pas plot 7 dekadash është rikthyer në strehën ku e përzunë së bashku me familjen në 7 prillin e vitit 1939. Është rikthyer, sië thotë në një intervistë të gjatë për gazetën □Shekulli□, jo thjesht për të rifituar pronën që i takon me të drejtë, por për të ngritur aty një fondacion që do të mbajë emrat Martin dhe Mirash Ivanaj, babait



dhe xhaxhait, të cilët dhanë shumë për Shqipërinë në një periudhë të errët për të, sa sakrifikuuan gjënë më të shenjtë që kishin, familjen. Drita Ivanaj, flet në këtë intervistë për jetën e saj në mërgim, kujtimin e fundit me babain, punën në kompaninë automobilistike italiane □Fiat□, ndryshimet që kishte pësuar shtëpia dhe ëdo të bëhet më tej me këtë banesë, që dikur mbante 17 mijë libra.

### Për të gjithë ata që nuk ju njohin, kush është Drita Ivanaj?

Unë jam bija e Martin Ivanajt, njëkohësisht edhe mbesa e Mirash Ivanaj, ish-ministër i Arsimit në vitet □30, figura shumë të njohura në Shqipëri. Kam jetuar jashtë por megjithatë jam kthyer në Shqipëri pas gati 50 vitesh, për të riparë jo vetëm vendin tim të

Më të lexuarat SOT

Më të komentuarat SOT



Puna ime si zhidolo në Itali, kam shkuar me 500 femra



Arrestohet autori i vrasjes me thikë të ndodhur dje në xhami



Aldo Bare: Më rrahën në qeli, më thanë pse flet me Ramën



Greta Koçi drejtoreshë në Ministrinë e Brendshme, përflitet edhe për deputetë të PD-së



Andis Harasani, kompani në parajsën fiskale Virxhinia

### Përpjekja e PD-së për ndryshimin e anëtarit të KQZ-së synon:

- Kontrollin e procesit zgjedhor
- Deformimin elektoral
- Asnjë nga këto
- Nuk e di
- Zbatimin e kodit zgjedhor

[Votoni](#)

[Rezultatet](#)



Kam ikur nga kjo shtëpi në prill të vitit 1939. Në fillim kam jetuar në Itali, me mamanë time. Jam ndarë me babain ditën e pushtimit fashist të Shqipërisë në 7 prill 1939. Ai vdiq shpejt në Stamboll. Nuk pata mundësi ta shikoj më. Isha vetëm 5 vjeë kur e pashë për herë të fundit. Po kaq kur e lashë këtë shtëpi. Së bashku me nënën u nisëm në Itali ku jetuam për 12 vite. Në fillim të viteve '50, emigruam në ShBA, ku edhe vazhdova studimet. Gjatë gjithë kësaj periudhe kam jetuar në shtetin e Nju Jorkut.

#### Kur u kthyet në Shqipëri për herë të parë? Kishit një motiv?

Në Shqipëri për herë të parë u riktheva në vitin 1993. Arsyeja për të cilën u riktheva ishte pasi më bë një ftesë për të marrë dekoratën që iu dha xhaxhait tim Mirashit. Ishte një ceremoni që zhvillohej në qytetin e Shkodrës. Që nga ajo kohë jam rikthyer në Tiranë të paktën dy herë në vit. Arsyeja nuk ka qenë thjesht për të rimarrë pronën time, absolutisht jo për vete. Unë dëshiroja ta kisha këtë shtëpi si një mundësi për krijimin e një baze për fondacionin Ivanaj, në nder të emrit të babait dhe xhaxhait tim. Një fondacion e kisha krijuar në Nju Jork, ndërsa të dytin kisha dëshirë ta krijoja këtu.

#### Ruani ndonjë kujtim nga babai dhe xhaxhai?

Shumë, shumë pak. Isha shumë e vogël. Kujtoj vetëm që isha në ballkonin e shtëpisë. Në atë kohë Tirana ishte bosh. Kishte vetëm 3 shtëpi në këtë zonë. Po qëndroja në ballkon me mamanë time kur pashë babain dhe xhaxhain tim që na përshëndetën. Ata nuk kishin ndërmend të na linin në këtë moment. Ata dolën nga shtëpia në mëngjes si në të gjitha ditët e tjera, u drejtuan nga qendra ku kishin zyrat e tyre dhe nuk u kthyen më.

#### Sa vetë jetonit në këtë shtëpi? Ëndodhi më tej me vilën?

Kjo shtëpi është ndërtuar nga babai dhe xhaxhai im. U zhvendosëm këtu kur shtëpia kishte përfunduar. Xhaxhai ynë Mirashi, jetonte me mua, nënën dhe babain. Ai kishte ndërtuar edhe një tjetër shtëpi ngjitur pas nesh. Kemi jetuar bashkë, por pak sepse shtëpia sapo kishte përfunduar, kur Shqipëria u pushtua nga Komanda e Përgjithshme e Forcave të Armatosura Italiane. Që nga ajo ditë ne nuk mundëm ta gëzonim më, pasi shtëpia u konfiskua. Ajo mbeti kohë pas kohe në duart e njerëzve të tjerë. Pas italianëve natyrisht erdhi fundi i luftës. Sapo xhaxhai im u rikthye në Tiranë ai u vendos në këtë shtëpi, kjo edhe për faktin se vëllai i tij dhe babai im Martini kishte ndërtuar jetë në Stamboll. Në fillim të viteve '50, menjëherë pasi xhaxhai im u burgos, kjo shtëpi u shtetëzua. Në vitin 1970, ndërtesa shërbeu si rezidencë e Ambasadës Hungareze për disa kohë, për t'u kthyer më tej në zyra të Sigurimit të Shtetit Shqiptar dhe të Gardës së Republikës deri 3 vite më parë. Kohë kur unë më në fund futa këmbët në shtëpinë time.

#### Sa ka ndryshuar shtëpia nga periudha kur ju keni jetuar këtu?

Ka ndryshuar shumë. Shtëpia është modifikuar. Diku është shkëputur një pjesë dhe diku është shtuar. Shtëpia origjinale ka pasur 2 kate. Ajo kishte 14 dhoma. Nëna në kujtimet e saj më ka thënë se kishim një librari. Kishim një dhomë 15 metra e gjatë që ishte ndërtuar posaçërisht vetëm për të mbajtur librat e babait dhe të xhaxhait, kur raftet shkonin deri në tavan. Kishim 17 mijë volume me libra.

#### Ju keni nisur një punë. Ëdo të ndodhë më tej me këtë vilë?

Tani do të shikojmë. Fondacioni është kulturor-edukativ. Është një vend ku uroj që rinia shqiptare të mund të kristalizojë ideat e saj, jashtë feshë dhe politikës. Unë kam projektet e mia që aktualisht janë ende në letra. Projekti më i afërt është stabilizimi i fondacionit këtu. Një ide është që t'u ofrojmë strehim personave që vijnë nga jashtë për të dhënë mësim këtu apo për të bërë konferenca dhe seminare. Mendoj që të kemi një qendër kulture të brendshme me internet në mënyrë që këtu të bashkohemi për të komunikuar me botën për të bashkëpunuar me shoqata të tjera kulturore. Ne kemi një bashkëpunim të mirë me Arkivin Shtetëror Shqiptar dhe uroj që në të ardhmen ky bashkëpunim të jetë po kaq i frytshëm me të tjera institute akademike. Rinia shqiptare e sotme ka shumë cilësi dhe me këto cilësi mund ndërtojnë Shqipërinë e së nesërme.

#### Mirashi dhe Martini, fati i keq i dy figurave kombëtare

Mirashi dhe Martini mbeten dy figura të shquara shqiptare të periudhës së viteve '30. Martini ishte vëllai më i madh. Lindi në vitin 1988, ndërsa Mirashi më 1891, në qytetin e Podgoricës në Mal të Zi. Babai im Martin ishte avokat. Të dy bashkë me Mirashin u diplomuan në Romë. Ata ishin shumë të lidhur me njëritjetrin që kur ishin fëmijë. Jetuan gjithmonë bashkë. Mund të jetonin edhe në Itali por ata vendosën të ktheheshin në Shqipëri sepse e dinin që këtu kishte shumë punë për të bërë. Në fillim babai punoi si avokat në Shkodër dhe në Korëë, pastaj erdhi në Tiranë ku u bë gjykatës i Trupit Suprem dhe më vonë anëtar i Këshillit të Shtetit Shqiptar. Mirashi ndoqi një rrugë tjetër në karrierë. Ai u dallua më së shumti për rolin që pati në vënien e gurit të themelimit në

NJU JORK - Dhane, vjedhe, krim. Droni i krimeve është në disa prej zonave më ekskluzive dhe elegante të Manhattanit. Shifrat zyrtare



#### Julian Assange, kandidat për post politik në Australi

Themeluesi i faqes elektronike WikiLeaks, Julian Assange ka në plan të kandidojë për një post politik në Australi. Ai thotë se



#### Vejusha Jobs: Steve më mungon ëdo ditë

NJU JORK - Lauren Powell Jobs ka dhënë për Nbc intervistën e parë pas vdekjes së bashkëshortit: "Steve më mungon, na





Kalo në Abissnet pa ndryshuar numrin dhe përfito avantazhet e telefonisë tonë fikse

- ▶ 2000 lekë kohë bisedë dhuratë
- ▶ 0 lekë tarifë fikse mujore
- ▶ Çmimet deri -70% më lirë

+ 1 muaj internet falas nëse lidh edhe internetin.



[www.abissnet.al](http://www.abissnet.al) ▶ tërheqja e pazezistueshme e lirisë

arsimit 5-vjeçar fillor. Po kështu një meritë e veçantë ishte edhe ligji i ri i Arsimit, i njohur si Ligji Ivanaj që qëllimi i të cilit ishte krijimi i instituteve edukuese dytësore. Si Mirashi ashtu edhe vëllai i tij Martini patën një fund të hidhur, ashtu siç ishte edhe vetë fati i familjes së madhe Ivanaj. Martini ndërroi jetë në Stamboll në vitin 1940 pas një sëmundje të rëndë, ndërsa Mirashi ndërroi jetë si i burgosur politik në 22 shtator të vitit 1953 në Tiranë. Drita, trashëgimtarja e vetme dhe e fundit e familjes Ivanaj thotë se vetëm në vitin 1995 mundi të sjellë në Tiranë eshtrat e babait i cili prehet pranë të vëllait, Mirashit.

**Dritan Laci**

#### Videot e fundit



Aksidentet më komike të vitit 2012



Hakmerret ndaj shokut duke i ndarë



Ja dhe një zog i zgjuar, përdor



Bebja fle e rrethuar nga gjarpërinjtë

#### 4 Komente

**Bartholomew**

@Lili,  
Enveri injorant ?  
Nuk dua te komentoj epitetet, por do te jap vetem nje fakt.  
Ne vitin 1946, pa u mbushur 2 vite nga perfundimi i Luftes se Dyte Boterore, Enveri e hapi Fakultetin e pare te Universitetit te Tiranes, Institutin Pedagogjik.  
Beri ate qe Zogistet nuk e bene dot per 14 vite.

**lili**

enveri para ketyre ishte vetem nje ignorant ne cdo aspekt,bashke me nexhmijen!

**1988**

Martini ishte vëllai më i madh. Lindi në vitin 1988 ????

**ARI**

TE UROJ SUKSES NE PLANIN TUAJ, EDHE URIME QE ME NE FUND PAS AQ VUAJTJESH ARRITE ME MARRE SHTEPINE TENDE. URIME EDHE FAT

#### Shtoni një koment

Gazeta 'Shekulli' iu kërkon gjithë lexuesve të saj, që mundësisht të mos përdorin sharje, fyerje denigruese ndaj dinjitetit njerëzor nëpër komente. Në vend të tyre, faktet dhe argumentet tuaja logjike mund të jenë shumë më të fuqishme pa to. Me respekt dhe falemnderit për pjesëmarrjen tuaj, mjaft të vlefshme në punën tonë!

Ftojme lexuesit, që nëse kanë opinione mbi shkrimet e botuara te 'Shekulli' apo mbi tema të tjera të lira, mund të na kontaktojnë në adresën: [komente@shekulli.com.al](mailto:komente@shekulli.com.al)

Emri (jo i domosdoshem)

E-mail (jo i domosdoshem)

Website (jo i domosdoshem)

7 + 6 =  Captcha (e domosdoshme)



Click to enable Adobe Flash Player.